



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 37 , Datë 06 / 02 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.141Regj., datë 02.11.2017, e z.A. S, kundër Shefit të Klinikës nr.3 të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë¹/Kirurgji e Përgjithshme, z.N. K, me pretendimin për sjellje diskriminuese ndaj tij.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, z.A. S është me profesion mjek kirurg dhe ka gradën shkencore “Doktor” në “Sëmundjet kirurgjikale”. Nga muaji Qershor 2005 deri në muajin Gusht 2016 ka punuar si mjek kirurg në Spitalin Rajonal Durrës. Me shkresën me nr.4158 prot., datë 04.08.2016 të Ministrit të Shëndetësisë është miratuar transferimi i z.A. S, mjek kirurg, nga Spitali Rajonal Durrës në Shërbimin e Urgjencës Kirurgjikale QSUT “Nënë Tereza” Tiranë. Me Vendimin nr.501, datë 15.08.2016 ankuesi ka lidhur marrëdhëniet e punës me QSUT “Nënë Tereza” Tiranë. Ankuesi shprehet se, pas nënshkrimit të kontratës së punës, ka qenë në pritje dhe ka paraqitur këkesa të herë pas herëshme pranë Drejtorisë së këtij Institucioni për letër atashimin e tij në një nga shërbimet e kirurgjisë së Klinikës I ose Klinikës III, për shkak të mënyrës së organizimit të Shërbimit të Urgjencës Kirurgjikale sepse ky shërbim nuk ka shtretër në dispozicion për të shtruar dhe ndjekur pacientët e operuar. Me shkresën me nr.4686 prot., datë 03.10.2016 Drejtori i Përgjithshëm i QSUT Tiranë i është drejtuar Shefit të Shërbimit të Kirurgjisë së Përgjithshme III,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën QSUT Tiranë.

Prof.N. K dhe Shefit të Urgjencës Kirurgjikale.D.SH.M M. K, duke urdhëruar të dyja shërbimet të organizojnë punën për të planifikuar në ekipin që mbulon shërbimin 24 orësh të urgjencës kirurgjikale dhe mjekun A. S. Me datë 04.10.2016 z.S është paraqitur në stafin e Klinikës III dhe nuk është pranuar nga Shefi i kësaj klinike, z.K. Subjekti ankues citon se z.K i ka thënë: *“Përse erdhe ti këtu, ishe shumë mirë në Durrës. Përse nuk shkon tek Spitali Ushtarak ose në Senatorium, do jesh më mirë atje”*. Ndërkaq, pavarësisht refuzimit të z.K ankuesi shprehet se në ditët në vijm është paraqitur rregullisht në stafin e Klinikës III, në pritje të angazhimit të tij në punë, përfshirjen në aktivitetin kirurgjikal të të dy shërbimeve të Klinikës III dhe Urgjencës Kirurgjikale si dhe vendosjen në listat e rojes nga ana e Shefit të Shërbimit të Kirurgjisë III, Prof.N. K.

Të gjitha këto shqetësime dhe situatën diskriminuese ndaj tij, ankuesi ia ka bërë të njohur Drejtorisë së QSUT-së, përmes komunikimeve telefonike si dhe shkresave poshtëcituar:

- Me shkresën me nr.4686/2 prot., datë 11.01.2017 ka vënë në dijeni Drejtoritn e QSUT-së për mospërfshirjen e tij në listën e rojeve dhe i kërkon të ndërhyjë për të zgjidhur situatën.
- Me shkresën me nr.468/2 prot., datë 20.01.2017 ka vënë në dijeni Drejtorinë e QSUT-së dhe ka kërkuar ndërhyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm për ndalimin e situatës diskriminuese ndaj tij nga ana e stafit dhe Shefit të Klinikës III, Prof.K.
- Me shkresën me nr.4686/3 prot., datë 25.01.2017 i ka kërkuar Drejtorit të QSUT-së të sqarojë me Shefin e Klinikës III statusin e tij në mënyrë që të mos pengohet nga z.K të ushtronte aktivitetin e tij kirurgjikal në Klinikë.

Ndërkaq në komunikimin verbal dhe shkresor me Drejtorinë e QSUT-së ankuesit i është *thënë* se *“zgjidhe me z.K sepse për ne ti je në rregull. Ne t’i kemi dhënë letrat”*. Subjekti ankues shprehet se, Shefi i Klinikës III dhe stafi tij i ka drejtuar një letër Ministrit të Shëndetësisë, lidhur me pretendimet ndaj z.S. Me shkresën me nr.730 prot., datë 03.10.2016 Ministri i është përgjigjur dhe ndërmjet të tjerash citon se: *“...letrën e vlerësoj të hartuar dhe përpiluar në rrethana të rënda artificialisht”*. Po ashtu Ministri vlerëson të motivuar rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së *“Mbi organizimin e punës në Urgjencën Kirurgjikale”*.

Pavarësisht sa më sipër, ankuesi parashtron se situata vijon të mbetet e njëjtë, e pazgjidhur dhe se ai vazhdon të diskriminohet po njëjloj. Ankuesi shprehet se e gjithë kjo situatë diskriminuese i ka sjellë si pasojë edhe rëndimin e shëndetit mendor dhe fizik të tij, pasoja sociale, shëndetësore edhe mbi familjen e tij dhe për më tepër kjo ka çuar dhe në dequalifikimin e tij si mjek pasi prej një periudhe të gjatë gati 2 vjeçare nuk ka realizuar asnjë intervent kirurgjikal.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ndërhyjë për ndalimin e diskriminimit të tij nga ana e Shefit të Shërbimit të Klinikës III, z.N. K.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*

Për sa më lart dhe referuar dokumentacionit të depozituar, evidentohet se ankesa kishte mangësi të anës formale.

- Me shkresën me nr.1061/1 prot., datë 04.12.2017 ankuesit iu kërkua të plotësonte mangësitë e ankesës së tij².

Referuar nenit 91, pika 3 të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, i cili parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.*

Në procesverbalin e datës 06.12.2017, mbajtur pranë Zyrës së KMD-së, ankuesi citoi pretendimet e tij lidhur me shkakun e pretenduar.

Për sa më lart, pas plotësimit të elementëve formal të ankesës, si dhe referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përfshihet në fushën e veprimtarisë së Komisionerit dhe ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj.

1. Me shkresën nr.1061/2 prot, datë 14.12.2017 të Komisionerit iu kërkua informacion Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së dhe Shefit të Klinikës III, z.K, mbi pretendimin e ngritur nga z.A. S.

Me shkresat me nr.1 prot., datë 21.12.2017³, dhe me nr.730/15 prot., datë 27.12.2017⁴, Komisioneri është njohur me parashtrimet e dy subjekteve ndaj të cilëve drejtohet ankesa, lidhur me çështjen e z.A. S.

² Shpjegime për shkakun e pretenduar.

³ Shkresë e Shefit të Shërbimit të Kirurgjisë së Përgjithshme 2.

⁴ Shkresë e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së.

2. Me shkresën me nr.33 prot., datë 09.01.2018 Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion (specifikuar në shkresë) pranë Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me ankesën e z.S.
3. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 16.01.2018⁵, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të QSUT-së.

Drejtorja e Drejtorisë Juridike pranë këtij institucioni, znj.D.D, lidhur me rastin e z.A. S, theksoi faktin se QSUT-ja ka patur gjithë predispozicionin e mundshëm për të zgjidhur këtë rast. Znj.D citon se z.A. S të njëjtën çështje po e ndjek gjyqësisht dhe se në kërkesë padinë e tij ai i ka kërkuar gjykatës të konstatojë diskriminimin ndaj tij nga ana e QSUT-së (si punëdhënës) dhe Shefit të Shërbimit të Klinikës III, z.N. K.

Ajo kërkoj një afat kohor një javor, që QSUT-ja të paraqiste me shkrim parashtrimet e veta, si dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar në Urdhërin e Inspektimit.

Inspektorët u KMD-së u takuan dhe me Prof.N. K, Shef i Shërbimit të Klinikës III, i cili lidhur me pretendimet e z.A. S u shpreh se ai nuk ishte i përfshirë në Strukturën e Shërbimit të Klinikës III dhe kjo ishte e vetmja arsye se përse ai nuk mund ta përfshinte në aktivitetin kirurgjikal të kësaj klinike.

4. Me shkresën me nr.296/1 prot, datë 18.01.2018 QSUT-ja ka sjellë dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁶, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga z.S për diskriminim nga ana e Shefit të Shërbimit të Klinikës III, Z.N. K është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Kjo reflektohet në objektin e kërkesë-padisë së paraqitur para gjykatës kompetente nga vetë subjekti ankues, me nr.Akti 5868, datë 11.12.2017 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku shprehimisht në pikën 2, citohet se, kërkon:

“Detyrimin e palës së paditur Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, të ndalojë diskriminimin ndaj mjekut kirurg Dr.i Shkencave Mjekësore A. S...”

⁵ Në zbatim të Urdhërit nr.07, datë 09.01.2018, të Komisionerit.

Po ashtu, në citim të bazës ligjore, ankuesi i referohet akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat parashikojnë mbrojtjen nga diskriminimi dhe normojnë rregullimet përkatëse. Kështu, ankuesi citon:

Nenin 14 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” : “Ndalimi i diskriminimit”.

Nenin 1, të Protokollit 12 të kësaj Konvente “Ndalimi I diskriminimit në punësim”.

Nenin 9, i Kodit të Punës, i ndryshuar “Ndalimi i diskriminimit”.

Nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative “Parimi I barazisë dhe mosdiskriminimit”.

Nenin 2, 3, 12, 13, 36, 38, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhën prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë pretenduar dhe tek Komisioneri. Në ankesën e paraqitur pranë KMD-së ankuesi ka pretenduar për diskriminim dhe ka kërkuar ndërprerjen e situatës diskriminuese, të krijuar nga ana e punëdhënësit QSUT dhe Shefit të Shërbimit të Klinikës III, z.N. K. Të njëjtin pretendim ka ngritur dhe në kërkesën e tij para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku kërkon shprehimisht: *“Detyrimin e palës së paditur QSUT të ndalojë diskriminimin ndaj mjekut kirurg Arjan Salia”*.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime dhe prova janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor; atëherë konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

Përsa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr.141 Regj., datë 02.11.2017 të z.A. S.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit,*

që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga**

Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1,3,5,7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 2 e 3 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës me nr.141 Regj, datë 02.11.2017, të z.A. S, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.
2. Ky vendim mund të kundërshtohet gjyqësisht, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha : Punësim

Shkaku: Çdo shkak tjetër